



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 399 Akti

Nr. 573 Vendimi  
Tiranë, më 14.10.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Kryesuese
<b>Suela Zhegu</b>	Relatore
<b>Lulzim Hamitaj</b>	Anëtar

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Dajana Skura, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Theo Jacobs, në datën 14.10.2022, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Artan Gjermëni**, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;  
**Neni G** i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;  
**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;  
**Ligji nr. 96/2016**, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;  
**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;  
**Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017** i Gjykatës Kushtetuese.

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Subjekti i rivlerësimit Artan Gjermëni, gjatë periudhës së rivlerësimit ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës, si dhe ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

- 2.** Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në datën 16.12.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, zhvilloi procedurat e shpërndarjes së çështjeve me short, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Artan Gjermëni do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Lulzim Hamitaj dhe Alma Faskaj. Relatore e çështjes me short u zgjodh komisionere Alma Faskaj, e cila në datën 18.12.2019 ka paraqitur një kërkesë për dorëheqje, si dhe një kërkesë tjetër më 13.4.2021 për përjashtimin e saj nga procesi i rivlerësimit për subjektin Artan Gjermëni.
- 3.** Trupi gjykues i shortuar në datën 18.12.2019, përmes vendimit të datës 24.4.2020, ka vendosur me shumicë votash mospranimin e kërkesës për dorëheqje të komisioneres Alma Faskaj, ndërsa lidhur me kërkesën e dytë për përjashtimin e saj, një tjetër trup gjykues i shortuar nga mbledhja e Komisionit në datën 13.4.2021, përmes vendimit të datës 16.4.2021, ka vendosur përjashtimin e komisioneres Alma Faskaj nga shqyrtimi i dosjes së subjektit të rivlerësimit Artan Gjermëni.
- 4.** Komisionere Alma Faskaj u zëvendësua nga komisionere Etleda Çiftja, me cilësinë e relatores. Subjekti i rivlerësimit u njoftua për këtë zëvendësim dhe, njëkohësisht, iu kërkuar deklarimi i konfliktit të interesit për anëtarin e ri të trupit gjykues. Në datën 12.5.2021, subjekti deklaroi se nuk ka konflikt interesi me anëtarin zëvendësues të trupit gjykues.
- 5.** Në datën 24.5.2022, subjekti i rivlerësimit Artan Gjermëni ka paraqitur pranë KLGJ-së kërkesën për heqje dorë nga statusi i magjistratit, kërkesë të cilën e ka revokuar në datën 20.6.2022. Më pas, në datën 27.6.2022, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pranë Komisionit kërkesë për përjashtimin e komisioneres Etleda Çiftja nga gjykimi i çështjes, me pretendimin se nuk ofron garancitë për një gjykim të paanshëm dhe të pavarur për shkak të marrjes në cilësinë e të pandehurës, në një proces penal.
- 6.** Trupi gjykues i zgjedhur me short në datën 28.6.2022, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën e subjektit në datën 1.7.2022, me shumicë votash, ka vendosur të pranojë kërkesën e subjektit, për përjashtimin e komisioneres Etleda Çiftja nga shqyrtimi i mëtejshëm i çështjes.
- 7.** Në vijim, Komisioni, me shortin e hedhur në datën 4.7.2022, ka vendosur caktimin e komisioneres Suella Zhegu, si relatore në çështjen e subjektit të rivlerësimit Artan Gjermëni, e cila, më pas, deklaroi mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Subjekti i rivlerësimit u njoftua për këtë zëvendësim dhe, njëkohësisht, iu kërkuar deklarimi i konfliktit të interesit për anëtarin e ri të trupit gjykues. Subjekti deklaroi se nuk ka konflikt interesi me anëtarin e ri të trupit gjykues.
- 8.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), si dhe dokumentacionin e hetimit të kryer nga ana e Komisionit.
- 9.** Trupi gjykues i Komisionit, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur fillimin e hetimit administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme, për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuese

të trupit gjykues komisioneren Genta Tafa (Bungo). Anëtarët e trupit gjykues deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

**10.** Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga subjekti i rivlerësimit janë nisur procedurat e rivlerësimit, si vijojnë: (a) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, pranë ILDKPKI-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31; (b) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pranë DSIK-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35; (c) plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.

**11.** Në datën 14.9.2022, subjekti i rivlerësimit njoftoi Komisionin se ka paraqitur sërish përpara KLGJ-së kërkesën e tij për dorëheqje nga statusi i magjistratit, referuar neneve 64 dhe 65 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me shkresën e datës 13.9.2022.

**12.** Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.9.2022, ka vënë në dijeni Komisionin se me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.9.2022, ka vendosur:

*“1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. Artan Gjermëni, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të dorëheqjes së tij.*

*2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më 31.10.2022.*

*3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit z. Artan Gjermëni sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.*

*4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.*

Ky vendim i është përcjellë subjektit të rivlerësimit dhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në datë 26.9.2022. Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet e-mail të datës 13.10.2022, ka konfirmuar marrjen dijeni më datë 26.9.2022 mbi vendimin me nr. \*\*\*, datë 19.9.2022 të KLGJ-së.

**13.** Për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe për respektimin e së drejtës së subjektit për t’u dëgjuar, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në rrugë elektronike më 6.10.2022, ka njoftuar subjektin nëse ka vullnetin të marrë pjesë në seancë dëgjimore, ku fokusi i kësaj seance do të jetë përfundimi i procesit të rivlerësimit, në zbatim të paragrafëve 1 dhe 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.

**14.** Subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike me e-mail-in e datës 11.10.2022, ka njoftuar Komisionin se nuk dëshiron të ushtrojë të drejtën për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore.

## II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

**15.** Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**16.** Trupi gjykues i Komisionit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes bazuar në provat e administruara më lart, konstaton se:

i) Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016.

ii) Subjekti i rivlerësimit Artan Gjermëni ka ushtruar të drejtën për të dhënë dorëheqje, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016.

iii) Subjekti, me shkresën e datës 13.9.2022, ka paraqitur përpara KLGj-së, sërish kërkesën për dorëheqje nga statusi i magjistratit, referuar neneve 64 dhe 65 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

iv) Subjekti, në datën 14.9.2022, ka njoftuar Komisionin se ka paraqitur përpara KLGj-së kërkesën për dorëheqje nga statusi i magjistratit.

**17.** Neni 65 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes<sup>1</sup>.

**18.** Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon: *“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe, në këtë rast, procesi i rivlerësimit ndërpritet. 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.*

**19.** Neni 56 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar të drejtën e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, si vijon:

*“1. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit.*

*2. Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare, sipas pikës 1, të nenit 7, të ligjit “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”.*

**20.** Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017 i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ka interpretuar, ndër të tjera, lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, si vijon: *“[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve*

<sup>1</sup>1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.

*ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe, në këtë rast, procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës [...]”.*

**21.** Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka informuar se z. Artan Gjermëni deri në datë 12.10.2022 nuk ka paraqitur ankim ndaj vendimit nr. \*\*\*, datë 19.9.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me të cilin është miratuar kërkesa për dorëheqje e këtij subjekti.

**22.** Trupi gjykues mban parasysh jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, sipas së cilës akti i dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë humbjen e statusit të tij si subjekt rivlerësimi *ex officio*, në kuadër të përcaktimit kushtetues të nenit 179/b të Kushtetutës, si dhe pamundësinë e realizimit të qëllimit të procesit të rivlerësimit, duke pasur parasysh që, referuar nënparagrafëve “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, të nenit 58, të ligjit nr. 84/2016, qëllimi për kryerjen e procesit të rivlerësimit, i parashikuar në pikën 1, të nenit 179/b, të Kushtetutës realizohet, përfundimisht, nëpërmjet konfirmimit në detyrë apo shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Vullneti për të mos iu shmangur procesit të rivlerësimit, sipas përcaktimit të tij në dispozitat kushtetuese dhe në ligjin nr. 84/2016, shprehet vetëm nëpërmjet qëndrimit në detyrë dhe përfundimit të procesit të rivlerësimit. Në momentin që subjekti i rivlerësimit, me vullnetin e tij të lirë ndërpret detyrën funksionale, që e bën atë subjekt të procesit të rivlerësimit *ex officio*, duhet të marrë parasysh edhe pasojën ligjore që sjell dorëheqja nga detyra në ecurinë e procesit të rivlerësimit, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Në të njëjtën frymë arsyeton edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 78, datë 12.12.2017, ku shprehet: “Gjykata thekson se për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe, në këtë rast, procesi i rivlerësimit ndërpritet duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës”.

**23.** Në këto kushte, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta dhe ligji për dorëheqje nga detyra e gjyqtarit. Në këtë kuptim, trupi gjykues arrin në përfundimin se për sa kohë dorëheqja e subjektit të rivlerësimit përmbush kriteret e përcaktuara në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, atëherë pasoja juridike, që i atribuohet situatës faktike të parashikuar në këtë nen, do të duhet të zbatohet në tërësinë e saj, duke i kufizuar të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

**24.** Ky është një qëndrim i unifikuar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit në vendimmarrje të mëparshme, sipas së cilës orientohet Komisioni që, përveç ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, të vendosë edhe ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit, sipas pikës 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.

**25.** Ndërprerja e procesit të rivlerësimit, për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenet 64 dhe 65 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Artan Gjermëni, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
  2. Ndalimin e emërimit të z. Artan Gjermëni, si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
  3. Ky vendim i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
  4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
  5. Ankimi dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- U shpall në Tiranë, më 14.10.2022.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Genta TAFA (BUNGO)**

**Kryesuese**

**Lulzim HAMITAJ**

**Anëtar**

**Suela ZHEGU**

**Relatore**

*Sekretare gjyqësore*  
*Dajana Skura*